

**REKOMANDIMI NR. 84/635/KES, NË LIDHJE ME NXITJEN
E AKSIONIT POZITIV PËR GRATË**

(13 dhjetor 1984)

Këshilli i Komuniteteve Evropiane

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian, dhe në veçanti nenin 235 të tij,

Duke pasur parasysh projekt rekomandimin e dorëzuar nga Komisioni,

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Evropian,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik e Social,

Duke pasur parasysh që shumë veprime janë ndërmarrë në nivel Komuniteti për të nxitur mundësitë e barabarta për gratë; duke qenë se, në veçanti Këshilli miratoi , në bazë të neneve 100 dhe 235 të Traktatit, Direktivën 75/117/KES, 76/207/KES dhe 79/7/KES në lidhje me trajtimin e barabartë për burrat dhe gratë; duke qenë se instrumente të tjera ligjore janë duke u përgatitur;

Duke pasur parasysh që neni 2 i Direktivës së Këshillit 76/207/KES parashikon se ajo nuk do të prekë masat për nxitjen e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, në veçanti duke mënjanuar pabarazitë ekzistuese të cilat cenojnë mundësitë e grave në fushat e përmendura në nenin 1 të saj;

Duke pasur parasysh që dispozitat aktuale ligjore në lidhje me trajtimin e barabartë, të cilat kanë si synim t'i garantojnë të drejta individëve, janë të pamjaftueshme për eliminimin e të gjitha pabarazive ekzistuese nëse nuk ndërmerret një aksion paralel nga qeveritë, të dy palët e industrisë dhe organet e tjera të interesuara, për të neutralizuar efektet paragjyquese ndaj grave në punësim të cilat lindin nga qëndrimet, sjellja dhe strukturat sociale;

Duke pasur parasysh që, me rezolutën e tij të datës dymbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy në lidhje me nxitjen e mundësive të barabarta për gratë, Këshilli miratoi objektivat e përgjithshme të programit të ri të veprimit të Komunitetit në lidhje me nxitjet e mundësive të barabarta për gratë (1982 deri 1985), që nënkupton intensifikimin e aksionit për të siguruar respektimin e parimit të trajtimit të barabartë dhe nxitjen e mundësive të barabarta në praktikë nëpërmjet aksionit pozitiv (Pjesa B e programit), dhe shprehu vullnetin për të zbatuar masat e përshtatshme për arritjen e këtyre objektiveve;

Duke pasur parasysh që, në një periudhë krize ekonomike, aksioni që është ndërmarrë jo vetëm që duhet të vazhdojë, por dhe duhet të intensifikohet në nivel kombëtar dhe në nivel komuniteti me qëllim që të nxitet arritja e mundësive të barabarta në praktikë përmes zbatimit të veprimeve pozitive, në mënyrë më specifike në fushat e

pagesës së barabartë dhe trajtimit të barabartë për sa i përket mundësisë për t'u punësuar, trajnuar profesionalisht dhe promovuar ose për kushte pune;

Duke pasur parasysh që Parlamenti Evropian ka nënvizuar rëndësinë e aksionit pozitiv,

I rekomandon shteteve anëtare që:

1. Të miratojnë një politikë aksioni pozitiv që ka si synim eliminimin e pabarazive ekzistuese që cenojnë gratë në jetën e punës dhe të nxisin një balancë më të mirë ndërmjet sekseve në punësim, duke përfshirë masa të përshtatshme të përgjithshme dhe specifike, brenda kuadrit të politikave dhe praktikave kombëtare, duke respektuar në të njëjtën kohë sferat e kompetencës së të dy palëve të industrisë, me qëllim që:

a. të eliminojnë ose t'i kundërvihen efekteve paragjyquese ndaj grave në punësim ose që kërkojnë punësim që lindin nga qëndrimet, sjelljet dhe strukturat ekzistuese bazuar në idenë e një ndarjeje tradicionale të roleve në shoqëri ndërmjet burrave dhe grave;

b. të inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në profesione të ndryshme në ato sektorë të jetës së punës ku ato janë të përfaqësuara në numër të pakët, veçanërisht në sektorët e së ardhmes, dhe në nivele më të larta përgjegjësie me qëllim që të aktivizohen më mirë të gjitha burimet njerëzore.

2. Të krijojnë një kuadër që të përmbajë dispozita të përshtatshme që synojnë të nxisin dhe lehtësojnë vënien në veprim dhe zgjerimin e këtyre masave.

3. Të ndërmarrin, vazhdojnë ose nxisin masat e aksionit pozitiv në sektorët publikë dhe privatë.

4. Të ndërmarrin hapat për të siguruar që aksioni pozitiv të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur veprime që kanë ndikim në aspektet e mëposhtme:

- në informimin dhe shtimin e sensibilizimit të publikut të gjerë dhe të botës së punës për nevojën e nxitjes së barazisë së mundësive për gratë punonjëse,

- në respektimin e dinjitetit për gratë në vendin e punës,

- në studimet dhe analizat cilësore dhe sasiore në lidhje me pozitën e grave në tregun e punës,

- në shtimin e zgjedhjes profesionale dhe të më shumë aftësive përkatëse profesionale, veçanërisht nëpërmjet trajnimit profesional të përshtatshëm, përfshirë zbatimin e masave mbështetëse dhe të metodave të përshtatshme të mësimin,

- në masat e nevojshme për të siguruar që shërbimet për gjetjen e vendit të punës, orientimin dhe këshillimin kanë një personel të mjaftueshëm e të aftë për të ofruar një shërbim bazuar në ekspertizën e nevojshme për problemet e veçanta të grave të papuna,

- në inkurajimin e grave kandidate dhe në rekrutimin dhe promovimin e grave në sektorët dhe profesionet e të gjitha niveleve ku ato janë përfaqësuar në numër të pakët, veçanërisht për sa i përket pozicioneve me përgjegjësi,

- në përshtatjen e kushteve të punës; duke rregulluar organizimin dhe kohën e punës,

- në inkurajimin e masave mbështetëse siç janë ato që kanë për qëllim nxitjen e një ndarjeje më të gjerë të përgjegjësive profesionale dhe sociale,
- në pjesëmarrjen aktive të grave në organet vendimmarrëse, përfshirë ato që përfaqësojnë punonjësit, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit,

5. Të sigurojnë që veprimet dhe masat e përshkruara në pikat 1 deri 4 i janë bërë të njohura publikut dhe botës së punës, veçanërisht përfituesve potencialë, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe sa më gjerësisht që të jetë e mundur.

6. T'i mundësojnë komiteteve dhe organizatave kombëtare për mundësitë e barabarta që të japin një kontribut të rëndësishëm në nxitjen e këtyre masave, të cilat presupozojnë që këtyre komiteteve dhe organizatave u janë siguruar mjetet e përshtatshme të veprimit.

7. Të inkurajojnë të dy palët e industrisë, kur është e mundur, që të nxisin aksionin pozitiv brenda organizatave dhe vendeve të tyre të punës, për shembull; duke sugjeruar orientime, parime, kode të sjelljes së mirë ose praktikës së mirë ose çdo formulë tjetër të përshtatshëm për zbatimin e një aksioni të tillë.

8. Të bëjnë përpjekje gjithashtu në sektorin publik për të nxitur mundësitë e barabarta të cilat mund të shërbejnë si një shembull, veçanërisht në ato fusha ku janë duke u përdorur ose shfrytëzuar teknologjitë e reja të informacionit.

9. Të marrin masat e duhura për të mbledhur informacion në lidhje me masat e marra nga organet publike dhe private dhe të ndjekin dhe vlerësojnë këto masa, dhe për këtë qëllim t'i kërkojnë Komisionit:

1. Të nxisë dhe organizojë në koordinim me shtetet anëtare shkëmbimin dhe vlerësimin sistematik të informacionit dhe eksperiencës në lidhje me aksionin pozitiv brenda Komunitetit.

2. T'i paraqesë një raport Këshillit, brenda tre vjetëve nga miratimi i këtij rekomandimi, lidhur me progresin e arritur në zbatimin e tij, në bazë të informacionit që i është dhënë nga shtetet anëtare.